



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 4 Prill 2021

Nr. 336

VENDIM

- Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të ankimit për shkelje të parashikuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ndaj Partisë Bindja Demokratike
- Kërkues:** Zj. Andia Dragoj
- Ndaj:** Partisë Bindja Demokratike
- Baza Ligjore:** Nenet 19, paragrafi 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 23 dhe 24 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata, gjatë shqyrtimit administrativ,

VËREN:

I.Vlerësimi Paraprak

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me shkresën nr. 4356 prot., datë 24.04.2021, është depozituar nga zj. Andia Dragoj, ankimi administrativ ndaj Partisë Bindja Demokratike me pretendimin se, kjo e fundit ka përdorur imazhin e kërkueses në një nga spotet publicitare të titulluar “Voto për një rini me mundësi të barabarta!” publikuar në datë 14.04.201 në median vizive, pa marrë paraprakisht pëlqimin nga ana e saj.



Zj. Dragoj i është adresuar njëkohësisht si institucionit të Komisionerit për të drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ashtu dhe Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Lidhur me këtë të fundit, është cilësuar kompetenca e tij parashikuar në nenin 19, pika “ë”, e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili parashikon se: *“Komisioneri ka këto kompetenca: ...monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara fushatën zgjedhore, të gjitha aspektet e financimit të fushatës zgjedhore, si dhe pasqyrimin e fushatës në media...”*

Referuar nenit 23 të ligjit nr. 44/20151 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, *“Me fillimin e procedurës administrative, organi publik verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi.”* Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesën lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e saj.

Juridiksioni dhe kompetenca janë parakushte procedurale që duhet të plotësohen në mënyrë që të krijohet një marrëdhënie juridike procedurale e vlefshme.

Kjo kompetencë e Komisionerit, parashikuar në nenin 19, pika shkronja “ë” e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, lidhet me nenet 77,78, 79, 80, 81, 83, 84, 84/1, 85 , 92 dhe 171/1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 2 datë 30.01.2021, ‘Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive’, të Komisionit Rregullator në KQZ.

Për sa më sipër, referuar neni 24, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, *“Kur një organ publik merr një kërkesë, për një çështje që e vlerëson jashtë kompetencës të vet, ia përcjell kërkesën menjëherë, dhe në çdo rast jo më vonë se dy ditë nga marrja e saj, organit publik kompetent dhe njofton kërkuesin për këtë., Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se kërkesa është jashtë kompetencës së tij lëndore dhe nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ, për ankimin e depozituar nga zj. Andia Dragoj.*

PËR KËTO ARSYE:



Bazuar në nenet 19, paragrafi 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 23 dhe 24 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”:

V E N D O S:

1. Mosfillimin e shqyrtimit administrativ të ankimit ndaj Partisë Bindja Demokratike.
2. Ankimi dhe dokumentat e administruara t’i përcillen për kompetencë dhe vlerësim Komisionerit për të drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

